



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 01/248  
Datë: 24.02.2025

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 9 të Ligjit Nr. 06/L-059 për Kompleksin Memorial "Adem Jashari" në Prekaz, në pajtim me nenin 65 dhe 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 24 shkurt 2025, merr këtë:

**V E N D I M**

- Themelohet Këshilli Shtetëror për manifestimin gjithë-popullor për shënimin e Epopesë së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, e cila do të mbahet më datë: 5, 6 dhe 7 mars 2025, në këtë përbërje:
  - Z. Ejup Maqedonci, Ministër i Mbrojtjes, kryesues;
  - Z. Fadil Nura, Kryetar i Komunës së Skenderajt, bashkëkryesues;
  - Z. Hajrulla Çeku, Ministër i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, anëtar;
  - Z. Elbert Krasniqi, Ministër i Administrimit të Pushtetit Lokal, anëtar;
  - Z. Bashkim Jashari, Komandant i Forcës së Sigurisë së Kosovës, anëtar;
  - Z. Gazmend Hoxha, Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, anëtar; dhe
  - Përfaqësues nga Organizatat e Dala nga Lufta e UÇK-së, anëtar.
- Ftohen ta dërgojnë nga një përfaqësues:
  - Zyra e Presidentes;
  - Kuvendi i Kosovës;
  - Asociacioni i Komunave të Kosovës.
- Këshilli mund të themeloj Grupet e Punese relevante për arritjen e objektivave të këtij Këshilli.
- Obligohet Këshilli Shtetëror dhe institucionet përkatëse për zbatimin e këtij Vendimi.
- Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë